



Nr. 586 Prot.  
08.11.2000

*Republika e Shqipërisë*  
*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve*  
*Drejtoria e Teknikës dhe Sportit*

**URDHER**

Nr 494 date 2.11.2000

Ne zbatim te nenit 102, Pika 4 te Kushtetutes se Shqiperise

**Urdheroj**

1. Sektori Administrativ i Federatave Shqiptare te Sportit te shndrohet ne Agjensine e Sherbimeve te Sportit.
2. Ne detyren e Drejtorit te Agjensise se Sherbimeve te Sportit emerohet zoti Mirjan Hakani.
3. Ngarkohet Drejtori i Agjensise se Sherbimeve per Sportin qe, ne bashkepunim me Drejtorite e Sportit ne MKRS, te paraqese , brenda 15 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij Urdheri. per miratim prane Ministrit. strukturen organizative te Agjensise dhe statusin e saj.
4. Ngarkohet Drejtoria e Teknikës dhe Sportit dhe Drejtoria e Organizimit dhe Personelit e Ministrise se Kultures, Rinise e Sporteve per zbatimin e ketij Urdheri.
5. Ky Urdher hyn ne fuqi me 01.11.2000

**MINISTRI**

**Esmeralda URUÇI**





www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 33

Tiranë – E enjte, 3 mars 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 139, datë 24.2.2016	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Devoll, për njësinë administrative Qendër Bilisht, të pronës nr. 783, në zonën kadastrale 1202, dhe për një shtesë në vendimin nr. 1056, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Qendër Bilisht, të qarkut të Korçës”.....	2525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 140, datë 24.2.2016	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “THE STAR” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Salla S4, me ambientet e saj ndihmëse”, të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës.....	2527
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 141, datë 24.2.2016	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga tokë bujqësore në tokë truall, për ndërtimin e një fabrike nga shoqëria “Deutsch Color” .....	2528
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 24.2.2016	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore, në pronësi shtetërore, në fshatin Vojnik, njësia administrative Maqellarë, Bashkia Dibër.....	2529
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 24.2.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit” .....	2530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 144, datë 24.2.2016	Për planin vjetor të pranimit për vitin 2016, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil.....	2530

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 145, datë 24.2.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksioni i rrugës “Kinemaja e vjetër””, në Bashkinë Patos.....	2531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 24.2.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike”, në Bashkinë e Skraparit.....	2532
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 24.2.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Zgjerimi i varrezave publike”, në Bashkinë e Peqinit.....	2533
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 24.2.2016	Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave.....	2534
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 149, datë 24.2.2016	Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Shërbimeve të Sportit (ASHS).....	2535
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 150, datë 26.2.2016	Për lirim nga detyra.....	2536
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 151, datë 26.2.2016	Për lirim nga detyra.....	2536
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Drejtësisë nr. 232, datë 14.1.2016	Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore.....	2536
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 241/3, datë 19.2.2016	Mbi karakteristikat e materialit, elementet e sigurisë, elementet grafike dhe mënyrën e plotësimit të lejedrejtimit të ri të mjeteve rrugore.....	2538
Urdhër i përbashkët i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Financave nr. 755, datë 9.2.2016	Mbi tarifën për lëshimin e autorizimit për reklamat në rrugë.....	2540
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 13, datë 16.2.2016	Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016.....	2541
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 16.2.2016	Për fillimin e procedurave për miratimin e kërkesës së “EVN Trading” sh.p.k., për heqjen e licencës për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me nr. 179 seria T12, miratuar me vendimin nr. 124, datë 29.8.2012, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.....	2542

**VENDIM**  
**Nr. 149, datë 24.2.2016**

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SHËRBIMEVE TË SPORTIT (ASHS)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të neneve 6, 18 e 30, pika 1, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Agjencia e Shërbimeve të Sportit është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Agjencia e Shërbimeve të Sportit ofron shërbime për federatat shqiptare të sportit, shoqatat dhe klubet sportive që kërkojnë mbështetjen e saj, sipas kapacitetit infrastrukturor dhe financiar. Realizimi i këtyre shërbimeve bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi dhe në bazë të marrëveshjeve paraprake ndërmjet palëve.

3. Agjencia e Shërbimeve të Sportit asiston dhe mbështet me personel të specializuar dhe infrastrukturë federatat sportive në Republikën e Shqipërisë për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare.

4. Agjencia e Shërbimeve të Sportit ofron shërbimet e mëposhtme për ekipet kombëtare dhe federatat sportive.

a) Akomodimin, kontrollin dhe trajtimin mjekësor për çdo kategori moshash të ekipeve kombëtare;

b) Administrimin dhe menaxhimin e ambienteve e të terreneve sportive, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;

c) Administrimin dhe menaxhimin e bazës materiale sportive, në dispozicion të ekipeve kombëtare;

ç) Ofrimin e mjediseve e të infrastrukturës tjetër të nevojshme për periudhën e grumbullimit të ekipeve kombëtare, sipas kalendarit të përcaktuar me parë;

d) Dhënien me qira të aseteve (zyra dhe mjedise sportive), sipas kuadrit ligjor në fuqi.

5. Agjencia e Shërbimeve të Sportit drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përfaqëson agjencinë, si dhe organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e saj. Drejtori i Përgjithshëm asistohet nga një zëvendës drejtor.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shërbimeve të Sportit emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

7. Rregullat dhe procedurat e funksionimit të brendshëm të Agjencisë së Shërbimeve të Sportit përcaktohen me rregullore të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

8. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë së Shërbimeve të Sportit rregullohen në bazë të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**